Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

13.10.2020, Prishtinë,
Ref:06.08.2020\1042-2020

Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj ankesës së Demira Krujezi kundër Insajderi.org

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të mbajtur më 30 shtator 2020, shqyrtoi ankesën e Demira Krujezi kundër Insajderi.org lidhur me publikimin e artikullit me titull: "TEK AUTO MITA FLAKË PO SHKON – SECILI KERRIN E VJETËR ME KERR TË RI PO E NDËRRON", dhe mori këtë:

V E N D I M

- Ankesa miratohet.

A R S Y E T I M I

Ankesa ka të bëjë me artikullin e publikuar në median Insajderi.org me titull: "TEK AUTO MITA FLAKË PO SHKON – SECILI KERRIN E VJETËR ME KERR TË RI PO E NDËRRON", dhe pretendimin se artikulli bënë shkelje të Kreut XII (Reklamat dhe sponsorizimi) e Kodit të Mediave të Shkruara.

Lajmi është shkruar në media online dhe objekt i kësaj ankese është teksti i shkruar, e që rrjedhimisht ankesa është e lejueshme për trajtim dhe e afatshme.

Pas leximit të artikullit dhe shqyrtimit të ankesës, KMShK gjen se ankesa është e bazuar.

Media ka publikuar një artikull i cili përmbanë kampanjën e një kompanie. Edhepse i gjithë lajmi është marketing, media nuk e ka shënjuar si të tillë. Kodi i mediave obligon mediat që të shënjojë me dallim materialin e sponsorizuar dhe të tregojë kush e ka sponsorizuar.

Andaj KMShK konsideron se ankesa është e bazuar, dhe se artikulli bënë shkelje të Kreut XII (Reklamat dhe sponsorizimi) e Kodit të Mediave të Shkruara.

KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës